




Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republik of Kosovo



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E VITISË - OPŠTINA VITINA

Pranuar - Priljen: Me/Dana 30.05.2014			
Nr. i organit Org. broj	Num. i Prilog	Shtoiçë Prilog	Vlera Vendos
01-013/764			



Komuna e Vitisë
Opština Vitina
Municipality of Vitina

RREGULLORE

PËR ORGANIZIMIN E TRANSPORTIT BRENDA TERRITORIT TË KOMUNËS SË VITISË

MAJ 2014
VITI

Në bazë të nenit 12.2, shkronja c, lidhur me nenin 40.2, shkronja a të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale të Kuvendit të Republikës së Kosovës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/1008 dhe nenit 36.2, shkronja c të Statutit të Komunës së Vitisë 01 Nr. 013/491, të datës 21.04.2011, Kuvendi i Komunës së Vitisë në seancën e mbajtur më 27.05.2014 aprovon këtë:

RREGULLORE

PËR ORGANIZIMIN E TRANSPORTIT BRENDA TERRITORIT TË KOMUNËS SË VITISË

I. Dispozitat e përgjithshme

Neni 1

1. Kjo rregullore ka për qëllim:
 - 1.1. Caktimin e parimeve dhe rregullave me të cilat rregullohen kushtet dhe mënyrat e ushtrimit të veprimtarisë së transportit në qarkullimin rrugor urban dhe urbano-periferik;
 - 1.2. Krijimin e kushteve për rregullimin e transportit taxi të udhëtarëve;
 - 1.3. Sigurimin e ofrimit të shërbimeve të transportit rrugor brenda territorit të komunës;
 - 1.4. Krijimin dhe mbështetjen e konkurrencës në mes të operatoreve të transportit dhe mbështetjen e interesave të udhëtarëve;
 - 1.5. Krijimin e kushteve për një transport të mirëfilltë të mallrave.

Neni 2

1. Shprehjet e përdorura në këtë rregullore kanë këtë kuptim:
 - 1.1. **“Licencë”** (e drejta për të kryer veprimtari të transportit të rregullt të udhëtarëve, apo të mallrave);
 - 1.2. **“Operator i transportit”** (personi juridik apo fizik i cili ushtron veprimtarinë e transportit publik);
 - 1.3. **“Drejtues i automjetit “** (personi i cili ka fituar shkallën e nevojshme të kualifikimit për drejtimin e një mjete motorik);
 - 1.4. **“Transport i rregullt udhëtarësh”** (shërbimi i rregullt i transportit në itinerar dhe vendqëndrime të pa ndryshuara, të ofruara nga transportuesit dhe të përcaktuara më parë shërbimi, i cili kryhet vetëm me autobus dhe mund të jetë urban, ndërrurban dhe ndërkombëtar);
 - 1.5. **“Transporti në llogari të vetë“** (transporti i mallrave me automjete transporti në ardhje apo vajtje, vetëm për llogari të vetë);
 - 1.6. **“Vendndalim”** (lokacioni i sinjalizuar ku u mundësohet ndalja e autobusëve për të zbritur dhe marrë udhëtarë);

- 1.7. **“Linjë”** (përmbledhja e nisjeve nga pikënisja e deri në pikërritja e stacionit të autobusëve, gjegjësisht në vendkalimin ku transportohen udhëtarët ose mallrat sipas rendit të publikuar dhe të regjistruar në një apo shumë nisje në atë relacion);
- 1.8. **“Relacioni”** (distanca në mes dy vendeve në linjë, të cilat në rendin e udhëtimit janë të regjistruara si stacione të autobusëve);
- 1.9. **“Tarifë”** (akti i cili përmban çmimin lidhur me transportin dhe kushtet tjera transportuese);
- 1.10. **“Rendi i udhëtimit”** (akti i cili përmban emrin e kompanisë transportuese, korridorin në të cilin kryhet transporti, llojin e linjës, renditjen e stacioneve të autobusëve apo vendbanimeve, si dhe distancën nga pikënisja apo stacioni ku fillon, kohën e nisjes dhe arritjes nga stacionet i autobusëve, gjegjësisht nga vendbanimet);
- 1.11. **“Transporti urban”** (do të thotë transport i ushtruar brenda kufijve të komunës);
- 1.12. **“Transporti urbano-periferik”** (do të thotë transport i ushtruar brenda territorit të komunës);
- 1.13. **“Transporti i lirë i udhëtarëve”** (do të thotë transport udhëtarësh jashtë shërbimit të rregullt, duke përfshirë shërbimet speciale të rregullta, që bartin grupe udhëtarësh të organizuar me iniciativë të udhëtarëve ose vetë bartësit);
- 1.14. **“Autotaxi”** (do të thotë transport jashtëlinjor i udhëtarëve, i cili kryhet me automjete të vogla dhe i cili plotëson kushtet sipas kësaj rregullore);
- 1.15. **Vozitje shtesë (bis-vozitje)** (Transporti me më shumë autobusë në të njëjtën kohë dhe rend të udhëtimit).

Neni 3

1. Operatori i pajisur me licencë nga MI-ja nuk ka nevojë për licencë komunale në lëmin e transportit të rregullt / linjor/të udhëtarëve.
2. Licenca është e domosdoshme për :
 - 2.1. Transport të rregullt urban dhe urbano-periferik të udhëtarëve;
 - 2.2. Transport taxi të udhëtarëve;
 - 2.3. Transport të mallrave;
 - 2.4. Licencat e lejuara nga komuna janë të vlefshme vetëm brenda territorit të komunës.

Neni 4

1. Komuna mban një regjistër të rendeve të udhëtimit të vërtetuara dhe licenca të lejuara.
2. Përcakton politikat e zhvillimit të shërbimeve të transportit të sigurt, efikas dhe ekonomik.
3. Nxjerr planin e transportit dhe e ndryshon atë sipas nevojës.
4. Plani duhet të jetë në përputhje me politikën e zhvillimit të tërësishëm të transportit në Kosovë.

Neni 5

1. Licenca vlen 5 vjet nëse organi që e ka lejuar nuk vendos ndryshe.
2. Licenca është e patjetërsueshme dhe e patransferueshme.
3. Rendi i udhëtimit vërtetohet për çdo 3 (tre) vite pas procesverbalit të lëshuar nga inspektori i Komunikacionit mbi shikimin e autobusit, përkatësisht mjetit të transportit publik.

4. Licenca për operator “taxi” dhe “auto-taxi” vlen 5 vite, ndërsa vërtetimi bëhet për ç’do vit, duke u bazuar në procesverbalin mbi shikimin e automjetit.

Neni 6

1. Kriteret, rregullat dhe dokumentet për dhënien e licencës i përcakton kjo rregullore bazuar në Ligjin e Transportit me Rregulloren me Nr.04/L-179 të Kuvendit të Kosovës.
2. Kriteret për rendin e udhëtimit në Transportin Publik Urbano-Periferik përcaktohen përmes kësaj rregulloreje.

Neni 7

1. Licenca jepet pas pagesës së taksave komunale të parapara me Rregulloren për Taksa, Ngarkesa dhe Gjoha, të aprovuar në Kuvendin Komunal të Vitisë.
2. Veprimtaria e transportit rrugor të udhëtarëve dhe mallrave kryhet në bazë të licencës.

Neni 8

Vërtetimi i rendeve të udhëtimit bëhet pas pagesës, vlerën e së cilës e përcakton Rregullorja për Taksa, Ngarkesa dhe Gjoha, e nxjerrë nga Kuvendi Komunal - Viti.

Neni 9

Transporti i rregullt urban dhe urbano-periferik

1. Transporti i rregullt urban dhe urbano – periferik ushtrohet në bazë të licencës dhe rendit të udhëtimit.
2. Ndalohet çdo ushtrim i veprimtarisë në transport të rregullt urban dhe urbano-periferik pa u pajisur me licencë dhe rend të udhëtimit.
3. Kushtet për marrjen e licencës janë:
 - 3.1. të ketë në pronësi së paku dy autobusë;
 - 3.2. të ketë të punësuar së paku 3 punëtorë prej tyre:
 - 3.2.1. vozitës profesional (kategoria D);
 - 3.2.2. mekanik, elektrikist apo profil tjetër për mirëmbajtje (apo të kontraktuar);
 - 3.2.3. një punëtor administrativ.
 - 3.3. të ketë biznesin e regjistruar pranë MTI- së;
 - 3.4. selia e kompanisë të jetë në territorin e Komunës së Vitisë.
4. Humbja e licencës:
 - 4.1. Kur nuk plotësohen kushtet e parapara me këtë rregullore;
 - 4.2. Vdes mbajtësi i saj;
 - 4.3. Kërkohet nga mbajtësi i licencës;
 - 4.4. Mbaron afati i licencës;
 - 4.5. Nëse e humbë aftësinë fizike dhe mendore;
 - 4.6. Në rastet kur operatori qëndron në vuajtje të burgut më tepër se 6 (gjashtë) muaj;
 - 4.7. Procedurën për revokim apo marrjen e licencës e ngritë inspektori i komunikacionit apo personi autorizuar pranë KK-së .Vendimin e merr organi që e ka lëshuar atë.

Neni 10

Rendi i udhëtimit

1. Relacionet urbane dhe urbano-periferike dhe numrin e orareve në to, përfshirë pikat fillestare dhe përfundimtare të relacionit i aprovon DSHPE-ja (Drejtoria për Shërbime Publike dhe Emërgjencë) në bazë të kërkesës dhe propozimit të Operatorit.
2. Vërtetimi i rendeve të udhëtimit bëhet në atë mënyrë që mos të preken drejtpërdrejt nisjet e operatorit tjetër, duke pasur parasysh kohën mbajtëse të nisjeve.
3. Transportuesi është i obliguar që transportin ta kryej në mënyrë të rregullt dhe sipas rendit të udhëtimit të vërtetuar dhe regjistruar.
4. Transportuesi mund që në një pjesë apo tërë linjën të ushtrij transportin edhe më shumë automjete (bisvoziqe) sipas rendit të vërtetuar dhe regjistruar të udhëtimit.

Neni 11

1. Transportuesi duhet ta filloj veprimtarinë e transportit të rregullt publik të udhëtarëve në afat prej 3 ditësh nga dita e fuqizimit të rendit të udhëtimit, dhe atë nuk mund ta ndërpres përderisa zgjat afati i rendit të udhëtimit.
2. Përjashtimisht nga paragrafi 1 i këtij neni, transportuesi mund përkohësisht të ndërpres veprimtarinë si rezultat i kushteve të jashtëzakonshme të cilat e pamundësojnë ushtrimin e veprimtarisë së transportit të rregullt.
3. Për ndërprerjen nga paragrafi 2 i këtij neni, transportuesi është i obliguar që të informojë organin i cili e ka vërtetuar rendin e udhëtimit, i cili organ do të lëshoj një vendim për pranimin apo refuzim të kërkesës së transportuesit.
4. Transportuesi nuk mundë ta ndërpret (pezulloj) veprimtarinë e transportit të rregullt në linjë sipas rendit të udhëtimit, të regjistruar dhe vërtetuar pa lejen e organit që e ka lëshuar atë rendë të udhëtimit.

Neni 12

1. Rendi i udhëtimit do të pezullohet nga organi që e ka lejuar atë në kushte kur :
 - 1.1. Në afatin prej 3 ditësh nga dita e fuqizimit nuk ja fillon veprimtarisë;
 - 1.2. Brenda një muaji kalendarik pa miratimin e organit që e ka lëshuar nuk e mban nisjen tri herë;
 - 1.3. Bënë ndërprerjen e kohëpaskohshme të mbajtjes së nisjes, respektivisht kur 12 herë brenda afatit të zgjatjes së rendit të udhëtimit nuk e mban nisjen pa miratimin e organit që e ka vërtetuar atë;
2. Vendimet i merr organi që e ka vërtetuar atë pas dëshmisë së inspektorit të komunikacionit pranë Komunës.

Neni 13

Operatori i transportit ka për detyrë që ndryshimin e rendit të udhëtimit dhe të drejtimit të transportit, ndaljen e përkohshme apo të përhershme të transportit në linjën e lejuar ta shpallë me anë të shtypit apo një mjeti tjetër të informimit.

Neni 14

1. Transportuesi përcakton çmimoren.
2. Çmimorja duhet të vërtetohet nga DSHPE-ja dhe Kuvendi i Komunës së Vitisë dhe të vendoset në autobus i cili qarkullon në atë linjë.
3. Personeli i autobusit merr pagesën vetëm në bazë të çmimorës nga paragrafi 1 i këtij neni.
4. Përfundimisht nga paragrafi 2 i këtij Neni, pagesa mundë të bëhet edhe mujore, me kusht që mujorja të shënohet (vërtetohet) për ç' do udhëtim të shfrytëzuar.

Neni 15

1. Kriteret, mënyra dhe procedura e regjistrimit, vërtetimit, revokimit dhe reregjistrimit të rrethave të udhëtimit si dhe caktimi i tarifave për to rregullohet me akte të veçanta juridike që e nxjerr Kuvendi Komunal me Drejtorinë e DSHPE-së në Viti.
2. Vetëm operatorët e pajisur me licencë dhe rend të udhëtimit të vërtetuara mund të ushtrojnë transport të rregullt të udhëtarëve.
3. Komuna mund t'ua vërteton rendin e udhëtimit për transport të rregullt (linjor) edhe pronarëve të automjeteve (me 9+1 ulëse), e më tepër në një relacion dhe orar të caktuar, për operatorët e pajisur me licencë.

Neni 16

Transporti TAXI

1. Transporti taxi është transport publik i personave në transportin jo të rregullt (jashtë linjor) rrugor për të cilin çmimi për rrugën e kaluar është që më parë i njohur dhe përcaktohet në bazë të taxi-metrit sipas çmimoreve të shërbimeve.
2. Çmimorja duhet të jetë e vendosur në vend të dukshëm brenda në automjet.
3. Taksimetri duhet të jetë në gjendje të rregullt, i atestuar dhe i vulosur sipas kushteve të përcaktuara për taksi-metër si dhe i vendosur në vend të dukshëm në automjet.
4. Transportuesi që kryen transport taxi të udhëtarëve është i obliguar që me kërkesën e udhëtarit ti jep atij dëshmi për shërbimin e bërë, e cila dëshmi përmban: regjistrimin e automjetit, relacionin, kohën e transportit, çmimin dhe nënshkrimin e transportuesit.

Neni 17

1. Transporti taxi mund të kryhet vetëm me 5 (4+1) ulëse dhe i cili i ka së paku katër dyer.
2. Automjeti sipas paragrafit 1 të këtij neni nuk mund të ketë mjet për bartje (rimorkio).
3. Me automjet taxi nuk mund të transportohen:
 - 3.1. Personat nën ndikimin e alkoolit, drogës dhe të sëmurëve me sëmundje të rënda ngjitëse.
 - 3.2. Kufoma, fëmijë nën moshën 6 vjeçare pa përcjellës,
 - 3.3. Material eksploziv, radioaktiv, helmues, që ndizen lehtë, infektive, armë të zjarra dhe armë të tjera të cilat rrezikojnë jetën dhe të mirat e qytetarëve në përgjithësi.

Neni 18

1. Personat që drejtojnë automjetin me të cilin kryhet transporti "taxi", përpos kushteve të përcaktuara me akte tjera normative të këtij ligji dhe ligjeve të tjera, duhet të kenë së paku 5 (pesë) vite posedimin e patentë shoferit për drejtimin e automjetit.
2. Personat që drejtojnë automjetin pa leje, i cili nuk ka leje për kryerjen e transportit auto-taxi të udhëtarëve dhe të mallrave, apo shenjen në automjetin taxi me shenjen e transportit linjor të udhëtarëve, përpos masave ligjore të ndëshkimit, do të përjashtohet nga trafiku nga inspektori i Komunikacionit, në bashkëpunim me PK-në (Policinë e Kosovës), në atë mënyrë ku do të merret leja e punës dhe reklama "Taxi" për 48-h deri në 5 ditë.
3. Aktvendimi për përjashtimin e automjetit taxi i dorëzohet drejtuesit aty për aty, dhe shpenzimet i bartë në tërësi drejtuesi i automjetit.
4. Automjetet taxi që janë të regjistruar për kryerjen e transportit taxi në territorin e komunave tjera nuk mund të kryej transportin në territorin e Komunës së Vitisë, vetëm në rastet kur të njëjtit udhëtarë i bartin edhe në kthim.
5. Transportuesit publik të udhëtarëve me 4+1 (auto-taxi) nuk mundë të transportojnë udhëtar më tepër se që kanë ulëse të regjistruara.

Neni 19

1. Drejtoria për Urbanizëm me DSHPE-në me vendim të veçantë do të përcakton:
 - 1.1. Numrin dhe shpërndarjen e stacioneve për taxi, mënyrën e shfrytëzimit të tyre, rregullimin, mirëmbajtjen si dhe numrin e automjeteve në taxi stacione;
 - 1.2. Në vendqëndrimet taxi vendosen automjetet taksi sipas rendit që kanë zënë, dhe drejtuesi i taksit është i detyruar të jetë në taksi automjet ose në afërsi të tij gjatë kohës deri sa të gjendet në vendqëndrimin e auto-taxive;
 - 1.3. Taxi – drejtuesi mund të marr për transport jashtë vendqëndrimit taxi vetëm në vendet ku nuk ndalohet ndalja dhe parkimi i automjeteve, por vetëm me kërkesën e udhëtarit nëse ai kërkon shërbimin e tij.

Neni 20

Kushtet për licencë "TAXI"

1. Për drejtues "taxi" kandidati duhet t'i plotësojë këto kritere:
 - 1.1. Çertifikatën e regjistrimit të Biznesit;
 - 1.2. Të jetë banor i Komunës së Vitisë;
 - 1.3. Të ketë patentë shoferin më të vjetër se 5 (pesë) vite;
 - 1.4. Të mos ketë pengesa juridike për ushtrimin e veprimtarisë për taksi drejtues;
 - 1.5. Çertifikatën mjekësore për shofer, vlefshmëria e sajë është 5 vite;
 - 1.6. Fotokopjen e Patentë Shoferit (të vërtetuar);
 - 1.7. Fotokopjen e librezës së qarkullimit të automjetit (të vërtetuar);
 - 1.8. Dy fotografi personale;
 - 1.9. Dëshminë për pagesën e Tatimit në Pronë;
 - 1.10. Procesverbalin mbi shikimin e automjetit pas pagesës së taksës Komunale.

Neni 21

1. Automjeti përveç kushteve të tjera të përcaktuara me ligj duhet t'i plotësojë edhe këto kushte:
 - 1.1. Të ketë katër dyer;
 - 1.2. Të ketë më së shumti 4+1 ulëse;
 - 1.3. Të ketë taksimetritin e vendosur në mënyrë të drejtë dhe në vend të dukshëm;
 - 1.4. Të ketë shenjen "taxi" mbi automjet;
 - 1.5. Çmimorja të jetë e vendosur në automjet asisoj që të jetë e dukshme për udhëtarin;
 - 1.6. Xhamat të mos jenë të ngjyrosur dhe të zënë me reklama;
 - 1.7. Të posedoj aparatit kundër zjarrit me dëshminë e vërtetuar ç' do 6 muaj;
 - 1.8. Në dyert anësore të ketë të shënuar emrin e operatorit taxi;
 - 1.9. Të ketë të kryer kontrollin teknike 6 (gjashtë) mujore;
 - 1.10. Të ketë të gjitha pajisjet tjera që kërkohen me Ligjin për Siguri në Trafik Nr.02/L-70;
2. DSHPE-ja së do të përcaktoj kushte më të përafërta shtesë në rast nevojë.

Neni 22

"Operator taxi"

1. Për marrjen e licencës "operator taxi" duhet ti plotësojë edhe këto kushte:
 - 1.1. Të ketë çertifikatë mbi regjistrimin e biznesit;
 - 1.2. Të ketë minimumin 5 automjete në pronësi ose në shfrytëzim, të cilat duhen të jenë të tipit të njëjtë dhe me ngjyrë të njëjtë;
 - 1.3. Të ketë minimumi 5 vozitës për "taxi" transport, sipas kriterëve të nenit 18, pika 1;
 - 1.4. Vendparkim, frekuenca, zyre, lidhje telefonike, servisit për mirëmbajtje të automjeteve.

Neni 23

1. Licenca tërhiqet nga organi që e ka lëshuar atë nëse:
 - 1.1. Kërkon mbajtësi i saj;
 - 1.2. Mbaron afati i vlefshmërisë;
 - 1.3. Vdes ose e humb zotësinë mbajtësi;
 - 1.4. Nuk i përmbush kushtet e parapara me këtë rregullore dhe ligjet e tjera në fuqi.
2. Bordi i Drejtorëve në bashkëpunim me DSHPE-në mund të përcakton numrin maksimal të licencave për taxi me vendim të veçantë.

Neni 24

Procedurën për marrjen e licencës e inicon Inspektori i Komunikacionit, Inspektori i transportit pranë Ministrisë apo personi tjetër i autorizuar nga Ministria dhe Komuna . Vendimin për revokimin e merr organi që e ka lëshuar.

Neni 25

Licenca për operator jepet pas një pagese, vlera e së cilës përcaktohet në bazë të Vendimit mbi Taksat Komunale dhe Administrative pranë K.K.

Neni 26

Transporti publik rrugor i mallrave

1. Operatori i transportit të mallrave, tek i cili kapaciteti i automjetit nuk e tejkalon peshën e ngarkesës mbi 12 tona është kompetent organi komunal për licencim.
2. Për ushtrimin e kësaj veprimtarie të transportit të mallrave, operatori apo personi fizik që transportin e shfrytëzon për nevoja personale duhet të pajiset edhe me leje komunale për mjetet e transportit nga 3.5 t e deri në 12 t.
3. Kriteret për leje komunale i përcakton DSHPE-ja për Komunën e Vitisë.

Neni 27

Procedurat, formën, përmbajtjen, afatet dhe kushtet tjera plotësuese për licencë i përshkruan DSHPE-ja.

Neni 28

1. Punët në inspektimin e transportit rrugor, urban, urbano-periferik, transportin auto-taxi dhe transportin e mallrave brenda territorit të komunës i bënë **Inspektori i Komunikacionit, dhe Policia e Kosovës**.
2. Inspektorët e Komunikacionit dhe të Transportit rrugor janë të detyruar që kontrollin ta kryejnë në pajtim me dispozitat e kësaj rregullore.
 - 2.1. Inspektimin dhe kontrollimin e operatorëve të transportit rrugor urban dhe urbano-periferik a janë duke ushtruar veprimtarinë e vetë në pajtim me dispozitat e kësaj rregullore dhe a e ushtrojnë atë në pajtueshmëri me licencë dhe rendë të udhëtimit;
 - 2.2. Inspekton dhe kontrollon të gjitha automjetet e transportit rrugor urban dhe urbano-periferik, objekteve tjera afariste, dokumentacionin dhe evidencat që i takojnë transportit rrugor urban dhe urbano-periferik;
 - 2.3. Inspekton transportin e mallrave, licencat, ngarkesat, urdhëresat rrugore etj;
 - 2.4. Kujdeset për organizimin dhe mbarëvajtjen e rregullt të transportit rrugor brenda territorit të komunës.

Neni 29

1. Operatori i transportit rrugor është i detyruar ti paraqes inspektorit të gjitha dokumentet e kërkuara dhe ti krijoj atij të gjitha lehtësitë për ushtrimin e kompetencave sipas rregullores dhe ligjeve në fuqi.
2. Kundër vendimit të inspektorit të Komunikacionit ankesa i drejtohet organit kompetent komunal.
3. Në ankesën kundër vendimit të organit kompetent komunal, respektivisht inspektorit të transportit rrugor në nivel të Kosovës vendos Ministria përkatëse.

Neni 30

Mbikëqyrja dhe zbatimi

1. Për zbatimin e kësaj rregullore dhe akteve tjera do të kujdesen drejtorit përkatëse si: Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Emergjencë dhe Urbanizmit - **inspektori komunal i Komunikacionit dhe Policia e Kosovës**.

2. Inspektori komunal i Komunikacionit dhe Policia e Kosovës në kuadër të autorizimeve të veta, shqipton gjoba mandatore dhe bënë fletëparaqitje për inicimin e procedurës kundërvajtës pranë Gjykatës Themelore në Gjilan - Dega në Viti, Departamenti për Kundërvajtje, kundër atyre të cilët veprojnë në kundërshtim me dispozitat e kësaj rregulloreje, ndërsa inspektori komunal i Komunikacionit bënë kërkesa, njoftime, leje, vendime dhe urdhëresa në funksion të zbatimit të kësaj rregulloreje.

II. Dispozitat ndëshkimore

Neni 31

1. Përpos dispozitave ndëshkuese, të parapara me Ligjin e Transportit Rrugor me Nr.04/L-179 të Kuvendit të Kosovës, me date 16.05.2013, dhe ligjeve tjera të aplikueshme për transport, me këtë rregullore parashihen edhe dispozita ndëshkuese për operatorët që komuna është përgjegjëse për lëshimin e licencave.
2. Me gjobë prej 30 deri 50 € do të dënohet për kundërvajtje operatori i transportit, gjegjësisht personi fizik apo juridik. Nëse vepron në kundërshtim me **Nenin 21**, nga nënpikat **1.1 deri në pikën 1.10**, pa pajisjet themelore për taxi të kësaj rregullore.
3. Me gjobë prej 50 deri 100 € do të dënohet për kundërvajtje nëse veprohet në kundërshtim me **Nenin 14**, pikat **1 dhe 2** (për pagesa të biletës dhe mujores) **dhe Nenin 16** pikat **2,3 dhe 4**, (pa çmimore, taksimetër dhe fatura) dhe **Neni 19**, **nënpika 1.3** (marrja dhe zbritja e udhëtarëve në vendet ku është e ndaluar ndalja dhe parkimi) të kësaj rregullore.
4. Me gjobë prej 50 deri 200€ do të dënohen për kundërvajtje operatori i transportit, gjegjësisht personi juridik, nëse nuk e mban linjën me rendin e udhëtimit të vërtetuar sipas **Nenit 13** dhe **Nenit 29**, pika 1 (për mosbashkëpunim me Inspektorin).
5. Me gjobë prej 100 deri 500€ do të dënohen të gjithë personat fizik dhe juridik të cilët veprojnë në kundërshtim me **Nenin 3**, **pika 2**, **nënpikat 2.1, 2.2, 2.4, 2.4** (pa licencë) në kundërshtim me **Nenin 9**, **pika 2** (pa licencë dhe rend të udhëtimit) të kësaj rregullore.

Neni 32

1. Me gjobë prej 100 deri 300€ do të dënohen operatorët e transportit të mallrave nëse veprojnë në kundërshtim me **Nenin 26**, **pika 1 dhe 2**, pa licencë dhe pa leje komunale.
2. Me gjobë prej 200 deri 500 € do të dënohen personat që ofrojnë shërbime "Taxi" pa leje përkatëse të punës, **Neni 18**, **pika 2, 4 dhe 5** (pa leje pune nga komunat tjera dhe mbingarkesë etj).
3. Me gjobë 100 deri 300€ do të dënohen të gjithë operatorët të cilëve u ka skaduar afati i licencës, pa rendë të vërtetuar të udhëtimit apo me licencë të huaj, d.m.th. sipas **Nenit 5**, **pikat 1,2,3 dhe 4** dhe **nenit 15 pika 1**.

Neni 33

Nëse operatori i transportit, përkatësisht personi fizik apo juridik bënë përsëritje të kundërvajtjes së njëjtë, atëherë përpos dënimit me gjobë do ti shqiptohet edhe masa mbrojtëse e ndalesës për ushtrimin e veprimtarisë së transportit në kohëzgjatje prej 3 deri në 6 muaj.

Neni 34

Për të gjitha çështjet e tjera të cilat nuk janë të parapara me këtë rregullore do të zbatohen dispozitat e Ligjit mbi Transportin Rrugor.

Neni 35

Në ditën e hyrjes në fuqi të kësaj rregullore shfuqizohet Rregullorja mbi Transportin Publik Urban dhe Urbano-Periferik për territorin e Komunës së Vitisë, të datës 01.07.2004, me numër 01-013-3073, dhe Rregullorja mbi Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores për Organizimin e Transportit në Komunën e Vitisë, të datës 20. 12. 2005, me numër 01-013-5875.

Neni 36

Kjo rregullore hyn në fuqi 8 ditë pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Vitisë

KRYESUESI I KUVENDIT

Naim Pira

